

## **Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve**

Njoftimi për projektaktet që i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrimit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

- a)** me postë elektronike;
- b)** me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;
- c)** me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
- d)** me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.

Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.